



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:255901  
Datë: 08.02.2024  
Numri i dokumentit: 05305082

**C.nr. 2980/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.P, të cilin e përfaqësojnë avokatët M.S B.S dhe N.S, me adresë në Rr. UÇK, kati i parë, nr. 5, Prishtinë, kundër të paditurës "...", me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensimin e dëmit për shkak të lëndimit në punë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, me datë 19.01.2024, mori dhe me datë 08.02.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET pjesërisht** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.P, ashtu që **DETYROHET** e paditura "...", që paditësit në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të lëndimit në punë, për 80% të përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit, t'ia paguajë shumat si në vijim:
- a. Në emër të dëmit material**
- Për përkujdesje të personit të tretë, shumën prej ..... 168,00 euro;
  - Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 112,00 euro;
- b. Në emër të dëmit jo material**
- Për frikën e pësuar, shumën prej..... 1.000,00 euro;
  - Për shëmtim trupor, shumën prej..... 750,00 euro;
  - Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....1,000.00 euro;
- II. **DETYROHET** e paditura "...", që paditësit shumat e aprovuara si më lartë t'ia paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit, ashtu që për format e dëmit jo material kamata do të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, ndërsa për format e dëmit material nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatë (datë: 02.09.2019) e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. **REFUZOHET si e pabazuar** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë shumat e refuzuara si në vijim: për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 1,000.00 euro, për frikën e pësuar

shumën prej 1,000.00 euro, për shëmtim trupor shumën prej 1,250.00 euro, në emër të rehabilitimit klimaterik, shumën prej 300,00 euro; për përkujdesje të personit të tretë, shumën prej 132,00 euro, për ushqim të përforcuar, shumën prej 188,00 euro;

- IV. **DETYROHET** e paditura “...”, që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,509.20 euro, brenda afatit prej 15 - pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

### I. *Padia dhe pretendimet e palëve*

Paditësi N.P përmes të autorizuarit të tij avokatura “...”, me datë 02.09.2019, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës “...” me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 28.07.2019. Paditësi në padi ka deklaruar se me datë 28.07.2019, rreth orës 07:45, derisa ishte duke punuar me eskavator më saktësisht gjatë zbritjes nga eskavatori e lëndon këmbën e djathtë ku më pas trajtohet në QKUK. Ka shtuar se, paditësi ditën e aksidentit ka qenë i punësuar tek e paditura dhe ka qenë duke i kryer detyrat për të cilat ka qenë i ngarkuar sipas Kontratës së punës. Ka theksuar se paditësi, në fatkeqësinë në punë ka pësuar lëndime trupore dhimbje fizike, frikë, ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe për ushqim të përforcuar.

Në seanca gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se, nga provat e administruara është vërtetuar mjaftueshëm baza juridike e kërkesë padisë së paditësit, dhe është vërtetuar se paditësit ditën e lëndimit ka qenë duke i kryer detyrat e tij të punës, tek e paditura, ku i njëjti ka pasur për obligim që të kontrolloj trasen e transportimit të thëngjillit, ndërsa nga ekspertiza e sigurisë në punë dhe fotove të bashkëngjitura të njëjtës, shihet se paditësi është detyruar që të kalojë përmes shkallëve të stërvjetëruara, të cilat nuk kanë ofruar as sigurinë minimale të paditësit ose punëtorëve të tjerë për qasje të sigurve në vendin e punës. Tutje ka theksuar se nga provat është vërtetuar se paditësi nuk ka bërë asnjë veprim të pa kujdesshëm apo në kundërshtim me normat e lëvizjes në vendin e punës, nuk ka kaluar nëpër ndonjë rrugë të shkurtër por e ka shfrytëzuar rrugën – shkallët të cilat i ka shfrytëzuar çdo herë deri në momentin e lëndimit. I ka propozuar gjykatës që kërkesë padia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i pa specifikuar.

E paditura në përgjigje në padi ka theksuar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit në këtë çështje juridike si nga baza ashtu edhe nga lartësia. Ka shtuar se ka mungesë të legjitimitet pasiv në këtë çështje juridike kontestimore pasi që lidhur me rastet e dëmeve që vijnë nga lëndimet në punë, për kohën e lëndimit të paditësit, e paditura ka nënshkruar kontratën me kompaninë e sigurimeve “...” për të gjitha kompensimet e mundshme për lëndimet në punë. Ka shtuar se, deri tek lëndimi i paditësit në vendin e punës ka ardhur si rezultat e mos zbatimit të procedurave të sigurisë në procesin e punës dhe veprimi jo i sigurve i paditësit. Tutje ka theksuar se, e paditura ka përmbushur detyrimin e saj sa i përket kushteve të punës, kjo pasi që i njëjti ka qenë i aftësuar nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, dhe ka qenë i pajisur me mjete

mbrojtëse, si dhe paditësi është dashur që ketë kujdes gjatë ecjes nëpër shkallë të cilat ishin sipas standardeve dhe se lëndimi i paditësit ka ardhur si pasojë e veprimit të pasigurte të tij.

Në seanca gjyqësore përfaqësues i të paditurës ka deklaruar se, i mungon legjitimiteti pasiv të paditurës, pasi në kohën e lëndimit të paditësit, e paditura ka pasur të nënshkruar Kontratën për Shërbimet e Sigurimit Shëndetësor, për punëtorët e saj, me kompaninë e sigurimeve Eurosig. Tutje ka theksuar se në procedurës gjyqësore, e paditura ka ofruar argumente të mjaftueshme se lëndimi i paditësit ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë së vet paditësit, dhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

## *II. Vërtetimi i gjendjes faktike*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 19.01.2024, sipas propozimit të palëve, ka administruar provat relevante dhe atë: fletëparaqitja për fatkeqësi në punë i datës 08.08.2019, raporti i emergjencës i SHSKUK-se i datës 28.07.2019, raporti specialistik i datës 30.07.2019, udhëzimi konsultim nr. 001689 i datës 28.07.2019, raporti i komisionit të të paditurës nr. 1679 i datës 08.08.2019, procesverbali lidhur me marrjen e deklaratës të punësuarit N.K i datës 28.07.2019, procesverbali lidhur me marrjen e deklaratës të punësuarit S.S. i datës 28.07.2019, procesverbali lidhur me marrjen e deklaratës të punësuarit N.P i datës 28.07.2019, kontrata e punës e datës 01.01.2016, dokumenti i titulluar “Përshkrimi i vendeve të punës”, dokumenti i titulluar “Siguria e ekzekutimit – garancion” nr. 00046 i datës 01.10.2017, kontrata publike kornize e datës 13.10.2017, nr. 1886, ekspertiza mjekësore nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë e datës 21.06.2022, ekspertiza mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë e datës 16.05.2023.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditësit është pjesërisht e bazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi është i punësuar tek e paditura në pozitën manipulues i kabinës – ekskavatorist, ndërsa ky fakt vërtetohet edhe nga Kontrata e punës me nr. 7638/0, e datës 01.10.16. Kontestuese në mes të palëve ishte baza juridike e kërkesë padisë, dhe legjitimiteti real pasiv i të paditurës në kompensimin e dëmit.

Nga fletëparaqitja për fatkeqësi në punë, e datës 08.08.2019, vërtetohet se me rastin e lëndimit të paditësit në vendin e punës, e paditura kishte hartuar fletëparaqitjen për fatkeqësi në punë, sipas të cilës vërtetohet se lëndimi i paditësit kishte ndodhur në vendin e punës, me datë 28.07.2019, në ora 7:45 minuta.

Nga raporti i komisionit i të paditurës nr. 1679 i datës 08.08.2019, vërtetohet se e paditura përmes komisionit profesional përkatës të saj, kishte hartuar raport, në të cilin raport komisioni profesional tek e paditura kishte konstatuar se, me datën 28.07.2019 në ndërrimin e parë në ora 7:30 minuta, duke kontrolluar shiritin, pasi që është shfaqur një shkëputje në shirit, duke tentuar

të ngjitet shkallëve për të komunikuar me prijësin e etazhës, është lënduar punëtori N.P – këtu paditësi. Ky raport përshkruan se komisioni profesional i të paditurës kishte dalur në vendin ku ka ndodhur lëndimi i paditësit me datë 01.08.2019 (lëndimi i paditësit kishte ndodhur me datë 28.07.2019), dhe kanë konstatuar se shkallët, në të cilat paditësi është lënduar kanë qenë të kalueshme.

Nga dokumenti i titulluar Siguria e Ekzekutimit - Garancion, me nr. 00046, datë 01.10.2017, vërtetohet se kompania e sigurimeve "...", kishte konfirmuar për të paditurën "...", se të njëjtit janë garantues për të paditurën për shërbimet e sigurimit shëndetësor për të paditurën deri në shumën prej 368,065,44 euro, ndërsa nga Kontrata Publike Kornizë për Shërbime, Kontrata me numër 1886, datë 13.10.2017, e lidhur në mes të Kompanisë së sigurimeve "...", dhe të Paditurës "...", vërtetohet se e paditura kishte kontraktuar tek kompania e sigurimeve në fjalë mbulimin e shërbimeve të sigurimit për punëtorët e saj me kontrata me afat të caktuar dhe me afat të pacaktuar, për periudhën 01.10.2017 deri me datë 30.09.2020. Sipas Kontratës Publike Kornizë për Shërbime, Kontrata me numër 1886, datë 13.10.2017, në pjesën e Kontratës të titulluar kushtet e veçanta, pika 11.1 e këtyre kushteve të veçanta, përcaktohet se në mes të palëve kontraktuese (kompanisë së sigurimeve dhe të paditurës) është kontraktuar që kompania e sigurimeve mbulon dëmet në rastet e vdekjes aksidentale të punëtorëve para daljes në pension, si dhe kompensimin në rast të paaftësisë për punë deri në 40% tek punëtorët, ndërsa nga Kontrata nuk shihet se janë të kontraktuara edhe mbuluesia e dëmeve të tjera të Kontratës.

Me qëllim të vërtetimit të bazës juridike të kërkesë padisë, gjykata me propozimin e palëve ka aprovuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e punuar nga eksperti H.H., i cili sa i përket rastit të lëndimit të paditësit në vendin e punës ka dhënë mendimin dhe konstatimin se lëshime ka pasur nga punëdhënësi dhe nga punëtori – këtu paditësi. Ka theksuar në ekspertizë se, kontrolli dhe mirëmbajtja e infrastrukturës dhe pajimeve teknologjike është përgjegjësi e punëdhënësit sipas Ligjit për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, dhe se punëtori – këtu paditësi është trajnuar vetëm njëherë për detyrat e tij të punës, por për një gjë të tillë nuk ka evidenca tek e paditura. Ka shtuar se si lëshim i të paditurës po ashtu konsiston në faktin se punëdhënësi ka kërkuar nga paditësi që të kryejë detyra të punës jashtë Kontratës pa një njoftim detal lidhur me atë vend pune, e po ashtu punëdhënësi nuk ka mbajtur ditarin e punës, si dhe nuk ka kryer veprimet procedurale pas lëndimit të paditësit, dhe nuk e njoftuar inspektoratin e punës lidhur me lëndimin e paditësit. Ndërsa si lëshime të paditësit ka listuar se paditësi nuk ka ndërmarrë masat e nivelit adekuat të sigurisë për mbrojtje të vetvetes, dhe se nuk është dashur që të fillojë punën pa marrjen e masave adekuate apo njoftim lidhur me gjendjen e mburojës së shkallëve ku janë kryer punët.

Me qëllim të qartësimit të ekspertizës së punuar, gjykata ka ftuar ekspertin e mbrojtjes dhe sigurisë në punë në seancë gjyqësore, i cili ka deklaruar se, në bazë të asaj çka është hulumtuar tek e paditura dhe në shkresat e lëndës, është konstatuar se lëndimi ka ardhur si pasojë e mbrojtjes anësore të shkallëve që ishin në ngritje të transporterit. Ka shtuar se paditësi ka qenë në pozitën e pulltisitit (manipulim i shiritit, lëshimin dhe ndaljen e shiritit)) dhe se në vendin e punës ku ka punuar paditësi kishte ndodhur një defekt ku kanë ardhur disa pjesë të shiritit pranë vendit të

punës së paditësit dhe i njëjti punëtor ka zbritur disa herë për të shikuar gjendjen e defektit që kanë ndodhur pranë tek shiriti transportues, ku edhe duke zbritur shkallëve, anësorja e shkallëve është shkëputur dhe paditësi ka lënduar këmbën pasi që ka rënë nga shkallët. Eksperti po ashtu në seancë gjyqësore ka theksuar se është përgjegjësi e punëdhënësit kontrollimi i vazhdueshëm i vendit të punës, për të siguruar mjedis të sigurtë për punëtorët. Ka theksuar se paditësi nuk ka ndërmarrë veprime në kundërshtim me rregullat e vendit të punës, por i njëjti ka qenë dashur të konstatoj gjendjen e shkallëve. Tutje në seancë eksperti ka theksuar se, nga e paditura nuk i është prezantuar asnjë rregullore mbi rregullat e kryerjes së detyrave të punës, por që e ka intervistuar paditësin lidhur me trajnimet që i ka ndjekur për siguri dhe mbrojtje dhe siguri në punë, dhe paditësi e ka njoftuar se e ka kryer vetëm një trajnim për mbrojtje dhe siguri në punë. Tutje ka theksuar se, nga e paditura nuk i është ofruar asnjë dokument ose evidencë e cila e dëshmon se kur është mbajtur trajnimi, apo nëse është mbajtur trajnimi i paditësit për mbrojtje dhe siguri në punë, apo jo dhe se për këtë ka kontaktuar edhe inspektorin e mbrojtjes dhe sigurisë në punë tek e paditura, N.M, i cili i udhëheq mbrojtjen dhe sigurinë në punë tek e paditura, në minierën e "...", nga i cili ka kërkuar të i ofroj dokumentacionin për çështjen e organizimit, menaxhimin e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, trajnimin e paditësit, pajisjen me mjete mbrojtëse, dhe nga të gjitha këto personi përgjegjës nuk i ka ofruar asnjë nga këto prova të kërkuara.

Gjykata, për nevojat e vërtetimit të gjendjes faktike të këtij rasti, ekspertizën e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e konsideroj të besueshme, ngase eksperti ekspertizën e tij e ka hartuar në mënyrë profesionale, dhe ka dhënë përgjigje në të gjitha detyrat e përcaktuara sipas aktvendimit të gjykatës për nxjerrjen e provës me ekspertizë.

### III. Vlerësimi i Gjykatës

Nga gjendja faktike e vërtetuar, gjykata vlerësoi se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Fillimisht sa i përket bazës juridike të kërkesë padisë, Gjykata sjell në vëmendje nenin 6 të Ligjit 04/L-161 për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, i cili rregullon si në vijim: 1. *Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurtë, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.* 2. *Punëdhënësi duhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike.* 3. *Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.* Sipas nenit 6, par. 3 të Ligjit për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, përcakton se në rastet e lëndimit të punëtorit në vendin e punës, vijnë në zbatim rregullat e përgjegjësisë objektive, pra rregullat e përgjegjësisë pa faj.

Ndërsa neni 5 par. 1 i Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, përcakton se: *Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurt dhe të shëndetshme në të*

*gjitha aspektet e punës. Kurse neni 6 par. 1 rregullon se: Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurtë, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.*

Çështja e kompensimit të dëmit përcaktohet me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligji nr. 04/L-077 (në vijim referuar si: LMD). Neni 154 i LMD-së, përcakton: *Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. Ndërsa neni 154 i LMD-së përcakton se: Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.*

Neni 158 i LMD-së, përcakton se: *1. Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet. 2. Zotëruesi i sendit lirohet nga përgjegjësia edhe në rast se provohet se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i palës së dëmtuar ose i personit të tretë gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihte dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i shmangë ose t'i mënjanojë. 3. Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia pjesërisht në rast se pala e dëmtuar pjesërisht ka kontribuar në shkaktimin e dëmit. 4. Në rast se në shkaktimin e dëmit ka kontribuar pjesërisht personi i tretë, ky person i përgjigjet palës së dëmtuar solidarisht bashkë me zotëruesin e sendit. 5. Personi që e ndihmon zotëruesin në përdorimin e sendit nuk konsiderohet si person i tretë.*

Referuar gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë dhe dispozitave ligjore të lartë cituara, gjykata vlerëson se e paditura është kompani e cila si aktivitet të saj afarist ka prodhimin e energjisë elektrike, e që rrjedhimisht një aktivitet i tillë konsiderohet si veprimtari e rrezikshme, kjo për faktin se gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie kërkohet operimi me makineri të veçanta, e që operimi me të njëjtat përmban një kuantum më të madh të rrezikut eventual për shkaktimin e dëmit ndaj personave të tretë. Duke qenë veprimtari e rrezikshme, për dëmet e shkaktuar si pasojë e zhvillimit të veprimtarisë së rrezikshme zbatohen rregullat e përgjegjësisë objektive, pra përgjegjësisë pa faj.

Në funksion të kësaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se paditësi në momentin e lëndimit, ishte në vendin e tij të punës dhe duke i kryer detyrat e tij të punës të përcaktuara Kontratë të Punës dhe me përshkrimin e detyrave të punës. Nga fletë paraqitja për fatkeqësi në punë, por edhe nga ekspertiza e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, është konstatuar se lëndimi i paditësit kishte ardhur si pasojë e këputjes së anësoreve mbajtëse të shkallëve të cilat i njëjti i ka shfrytëzuar me rastin e shkuarjes në pozitën ku i njëjti ka punuar si manipulues me shirita. Ekspertiza e mbrojtjes dhe sigurisë në punë ka konstatuar se e paditura nuk ka kryer kontrollimin e infrastrukturës dhe pajimeve teknologjike, të cilat shfrytëzohen nga

punëtorët gjatë kryerjes së detyrave në vendin e punës, dhe se e paditura nuk ka ofruar asnjë dëshmi se paditësi ka qenë i trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se nga provat në përgjithësi, e nga ekspertiza e mbrojtjes dhe sigurisë në punë në veçanti është vërtetuar se e paditura kishte përgjegjësi primare në lëndimin e paditësit gjatë kryerjes së detyrave të tij të punës. Kjo për faktin se, nga neni 5 i Ligjit për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, qartazi është përcaktuar se punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës për punëtorët. Gjykata po ashtu vlerëson se, nga konstatimet e lartë cituara, neni 6 i Ligjit për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, përcakton se punëdhënësi i përgjigjet punëtorit për lëndimet në vendin e punës sipas rregullave të përgjegjësive objektive, ndërsa kur zbatohen rregullat e përgjegjësive objektive, sipas nenit 158 të LMD-së, e paditura mund të lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar vetëm në rastet vërtetohet se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i palës së dëmtuar ose i personit të tretë gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihte dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i shmangë ose t'i mënjanojë, ndërsa në rastin konkret nga ekspertiza është konstatuar se e paditura ka përgjegjësi primare në rastin e lëndimit të paditësit.

Gjykata ka vlerësuar po ashtu edhe pretendimet e palës së paditur se të njëjtës i mungon legjitimiteti real pasiv, pasi që në kohën e lëndimit të paditësit, e paditura kishte të kontraktuar policë të sigurimit sipas kontratës me kompaninë e sigurimeve "...", andaj përgjegjësia për shkaktimin e dëmit duhet ti atribuohet kompanisë së sigurimeve. Këto pretendime të palës së paditur gjykata i gjen si të pabazuara. Kontrata për sigurimin është kontratë në të cilën palët kontraktuese dakordohen që i siguruari ti paguaj siguresit një shumë të caktuar, ndërsa siguresi merr përgjegjësinë që në rast se ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, të siguruarit t'i paguajë një shumë të caktuar ose të kryerje diçka në llogari të tij. Një përkufizim i tillë përcaktohet edhe me nenin 918 të LMD-së, si në vijim: *Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguresi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t'i paguajë siguresit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër.* Në bazë të këtij përkufizimi gjykata vlerëson se Kontrata për sigurimin është Kontratë e cila rregullon raportin në mes të siguresit dhe të siguruarit, me qëllim që i siguruari të kontraktojë për veten e tij mbulueshmëri në raport me rastin e siguruar. Në rastin konkret gjykata vlerëson se, e paditura "... ka kontraktuar tek kompania e sigurimeve polisë të sigurimit me qëllim të mbulimit të shpenzimeve në rastet e lëndimit të punëtorëve në vendin e punës, por kjo nuk ndikon në të drejtën e paditësit që të paraqet padi ndaj vet shkaktarit të dëmit, ngase Kontrata e sigurimit rregullon raporte në mes të siguresit dhe të siguruarit, dhe pala e dëmtuar (paditësi) duke mos qenë palë nënshkruese e Kontratës së sigurimit, nuk mund të kufizohet në kuptimin e pamundësisë së paraqitjes së padisë ndaj vet shkaktarit të dëmit. Thënë thjeshtë, të dëmtuarit i takon e drejta që në rrugë gjyqësore të kërkoj kompensimin e dëmit nga shkaktari i dëmit apo nga kompania e sigurimeve sipas zgjedhjes së tij, ngase fakti që shkaktari i dëmit ka të kontraktuar një polisë të sigurimit nënkupton që këtë polisë e ka kontraktuar që në rast se shfaqet rasti i siguruar, nga kompania e sigurimeve të kërkoj pagesën e shumës të cilën i siguruari e paguan tek pala e tretë. Në këtë situatë, gjykata vlerëson se e paditura ka legjitimitet real pasiv, ndërsa e njëjta mund të iniciojë procedurën e kërimit të regresit ndaj kompanisë së sigurimeve, për format e dëmit që pretendon

se ka të kontraktuar polisën e sigurimit. Për më tepër, gjykata sjell në vëmendje se sipas Kontratës me numër 1886, datë 13.10.2017, në pjesën e Kontratës të titulluar kushtet e veçanta, pika 11.1 e këtyre kushteve të veçanta, përcaktohet se në mes të palëve kontraktuese (kompanisë së sigurimeve dhe të paditurës "...") është kontraktuar që kompania e sigurimeve mbulon dëmet në rastet e vdekjes aksidentale të punëtorëve para daljes në pension, si dhe kompensimin në rast të paaftësisë për punë deri në 40% tek punëtorët, ndërsa nga Kontrata nuk shihet se janë të kontraktuara edhe mbulesa e dëmeve të tjera.

Meqenëse sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë, Gjykata ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguajë shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket shumave të aprovuara në emër të dëmit jo material, Gjykata shumat si më lartë i ka caktuar duke u bazuar në ekspertizat mjekësore të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësor, të hartuara nga eksperti i lëmisë së ortopedisë Dr. S.Sll dhe ekspertja e psikiatrisë Dr. S.B. Ekspertët në ekspertizën e hartuar pas ekzaminimit të paditësit dhe shkresave të lëndës, kanë konstatuar lëndimi i paditësit kualifikohet si lëndim i lehtë. Sa i përket dhimbjeve fizike, në ekspertizë është konstatuar se paditësi ka pasur dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë për 5 minuta për shkak të gjakderdhjeve të brendshme, dhembje të intensitetit të lartë për 3 ditë deri sa ka ardhur tek fillimi i tërheqjes së simptomave, dhembje të intensitetit të mesëm për tre javë deri tek tërheqja e plotë e simptomave, ndërsa dhembje të intensitetit të ulët për tre javë të tjera. Duke u bazuar në këto vlerësime të ekspertëve, gjykata ka caktuar në emër të dhimbjeve fizike shumën e kompensimit për paditësin prej 1,000.00 euro. Sa i përket frikës së përjetuar, ekspertët kanë konstatuar se me rastin e lëndimit paditësi ka përjetuar frikë primare për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për dyzet e tetë orë, dhe frikë sekondare të intensitetit mesatar dhe të ulët që ka zgjatur për tre deri në katër muaj. Duke u bazuar në këto vlerësime të ekspertëve, gjykata ka caktuar në emër të frikës së përjetuar, shumën e kompensimit për paditësin prej 1,000.00 euro euro. Sa i përket shëmtimit trupor, ekspertët në ekspertizën e hartuar, kanë konstatuar se tek paditësi si pasojë e lëndimit në vendin e punës është shkaktuar shëmtim trupor i shkallës së lehtë – ulët, për shkak të vragës me diametër 2 centimetër, dhe formë të rrumbullakët, ngjyrë e kaftë e mbyllët. Duke u bazuar në këto vlerësime të ekspertëve, gjykata ka caktuar në emër të shëmtimit trupor, shumën e kompensimit për paditësin prej 750.00 euro. Caktimin e shumave të kompensimit të dëmit jo material, Gjykata e ka bazuar në nenin 183 të LMD-së, i cili përcakton: *1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.*

Sa i përket formave të kompensimit të dëmit material, gjykata me rastin e aprovimit të shumave si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguajë shumën prej



168 euro në emër të ushqimit të përforcuar (duke llogaritur shumën prej 10 euro në ditë bazuar në 80% të përgjegjësisë së të paditurës, për njëzet e një ditë nga dhjetë euro, duke i zbritur 20%) dhe 140 euro në emër të ndihmës së personit të tretë (duke llogaritur shumën prej 10 euro në ditë bazuar në 80% të përgjegjësisë së të paditurës, për katërbëdhjetë ditë nga dhjetë euro, duke i zbritur 20%). Sipas ekspertizës mjekësore, nga ekspertët është dhënë konstatimi se paditësi si pasojë e lëndimit ka pasur nevojë për ushqim të pasur me vitamina, minerale, proteina për tre javë, dhe po ashtu paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë për dy javë, dhe atë ndihmë në ushqim, veshmbathje dhe nevoja higjienike. Gjykata për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i personit të tretë, vlerëson se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar, dhe vështirë i argumentuar me prova. Andaj pas analizimit të të gjitha provave ka ardhur në përfundim se shumata e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave.

#### IV. *Pjesa e refuzuar e kërkesëpadisë*

Sa i përket shumave të refuzuara në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata ka refuzuar shumat: për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 1,000.00 euro, për frikën e pësuar, shumën prej 1,000.00 euro, për shëmtim trupor, shumën prej 1,250.00 euro, për përkujdesje të personit të tretë, shumën prej 132,00 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 188 euro, ndërsa në tërësi shumën prej 300,00 euro të kërkuar në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik. Refuzimin e shumave në emër të kompensimit të dëmit jo material arsyetohet me faktin se, nga ekspertiza e mbrojtjes së sigurisë në punë është përcaktuar se paditësi ka pasur përgjegjësi sekondare në shkaktimin e dëmit, ngase sipas konstatimit të ekspertit paditësi ka pasur lëshime në rastin e lëndimit të tij në vendin e punës, sepse i njëjti ka treguar mos kujdesin e duhur dhe veprim të pa përgatitur në situatën konkrete, nuk ka ndërmarrë masat e nivelit adekuat të sigurisë për veten e tij në vendin e punës, dhe nuk është dashur që të fillojë punën pa marrjen e masave adekuate apo njoftim lidhur me gjendjen e mburojës së shkallëve ku janë kryer punët. Me nenin 176, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar*, andaj bazuar në këtë dispozitë ligjore Gjykata ka bërë ndarjen e përgjegjësisë 80% primare për të paditurën, dhe 20% sekondare për paditësin. Tutje, Gjykata vlerëson se, aprovimi i shumave më të larta se sa ato në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ishin të larta dhe në kundërshtim me qëllimin e kompensimit të dëmit jo material, i cili ka për qëllim satisfaksionin e paditësit për shkak të lëndimeve të pësura (kjo duke u bazuar edhe në udhëzimin e Gjykatës Supreme nr. 41/2023, të datës 07.02.2023).

Sa i përket rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik, gjykata ka refuzuar në tërësi shumën e kërkuar nga paditësi, kjo për faktin se paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka ofruar asnjë faturë ose kupon fiskal për të argumentuar faktin se i njëjti me qëllim të trajtimit fizioterapeutik ka kryer pagesa për këtë qëllim pranë ndonjë institucioni shëndetësor.

#### V. *Kamata dhe shpenzimet e procedurës.*

Sa i përket kamatës, Gjykata ka vendosur që e paditura shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paditësit t'ia paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit, kjo duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së i cili përcakton: *1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.* Ndërsa sa i përket kohës së llogaritjes së kamatës, në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi është gjykuar se kamata për shumat e aprovuara në emër të dëmit jo material fillon të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, ndërsa kamata në shumat e aprovuara në emër të dëmit material fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë (sa i përket lartësisë së kamatës dhe periudhës se kur fillon të llogaritet, gjykata u bazua edhe në mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i dt.02.12.2020).

Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, gjykata në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore ka obliguar të paditurën e dytë që paditësit t'ia paguajë shumën prej 1,509.20 euro, dhe atë duke llogaritur shpenzimet e krijuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104,00 euro, në emër të precizimit të kërkesëpadisë shumën prej 104 euro (për faktin se paditësi nuk ka mundur të paraqet shumat e sakta pa nxjerrjen e provave përmes ekspertizave përkatëse), në emër të përfaqësimit në seanca shumën prej 811,20 euro (6 seanca, secila në shumën prej 135,20 euro), për ekspertizë nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë shumën prej 150,00 euro, ndërsa në emër të ekspertizës mjekësore (ortopedi, psikiatri) shumën prej 300 euro. Me rastin e vendosjes përnuredi shpenzime të procedurës, Gjykata u bazuar në nenin 452, paragrafi 1 të LPK-së që përcakton: *Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore.*

Bazuar në të lartë cekurat, në bazë të nenit 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr. 2980/2019, datë 08.02.2024

**Gjyqtari,  
Florian Krasniqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.